ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **217-26-5504-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me sistem për detektim sinjali për nevojat e FSK-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**JOLIX SH.P.K.**
NUI	**811275024**
Adresa	**Rr. Musa Tolaj, Nartel Center, Lam A, Kati 12**
Vendi	**Prishtinë**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044 509 919**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Zaide Pira**
Adresa elektronike	**info@jolix-ks.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**06.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me sistem për detektim sinjali për nevojat e FSK-së

Njoftimi për kontratë është publikuar në platformën e-Prokurimi më 08.07.2026. Vlera e parashikuar e kontratës: 200,000.00 €. Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve dhe hapja e tenderëve: 25.08.2026, ora 14:00, përmes platformës e-Prokurimi. Janë pranuar 3 oferta. Kriteri për dhënien e kontratës: tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Njoftimi mbi vendimin e AK (B58), me të cilin u anulua aktiviteti i prokurimit, është publikuar më 23.10.2026.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

JOLIX SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK më 28.10.2026 (Nr. Prot. 6098), kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të 23.10.2026 dhe arsyeve të eliminimit të ofertës së saj (pikat 4.3 dhe 4.4 të Aneksit 1). AK e ka refuzuar kërkesën si të pabazuar me vendimin e datës 29.10.2026 dhe e ka lënë në fuqi Njoftimin mbi vendimin e 23.10.2026. Kopja e vendimit të AK të 29.10.2026 bashkëngjitet kësaj ankese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1, neni 6 dhe neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së (paragrafët 59.1, 59.2, 59.4 dhe 59.5)
Neni 62 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së (paragrafi 72.3)
Nenet 38.3, 39.7 dhe 40.8 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik
Dosja e Tenderit: nenet 28.2 (b), 29.1 dhe 29.2 të Informatave për Tenderuesit; Aneksi 1, pikat 4.3 dhe 4.4, dhe "Sqarimi Plotësues dhe i detyrueshëm për OE"; Kërkesa 11

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

A. Objekti i ankesës

JOLIX SH.P.K. ankohet kundër vendimit të AK të 29.10.2026, me të cilin u refuzua kërkesa e saj për rishqyrtim, si dhe kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të 23.10.2026 për anulimin e aktivitetit. Oferta e JOLIX (144,000.00 EUR) u eliminua vetëm për dy arsye: pika 4.3 (adapteri SnapN) dhe pika 4.4 (fotografia e backpack-ut). Asnjë kërkesë tjetër e DT-së nuk është kontestuar.

B. Pika 4.3: adapteri SnapN nuk është kërkesë e Dosjes së Tenderit

- Aneksi 1, pika 4.3, kërkon set kabllosh DF për antenë kompakte DF, me gjatësi 5 m, për instalim mobil, me garanci 12 muaj. JOLIX ofroi **R&S ADD5C-MMS (4121.3911.02), "Cable set for ADD507 up to 8 GHz, 5 m"**, të listuar në kuotimin e prodhuesit nr. 1170419.0 të dorëzuar me ofertë. AK nuk kontestoi asnjë nga këto kërkesa. Adapteri SnapN nuk përmendet askund në DT. Eliminimi për një artikull që DT nuk e kërkon shkel nenin 28.2 (b) të Informatave për Tenderuesit dhe nenet 7 e 59.4 të LPP-së.
- Konstatimi bazohet në katalogun PR200 **v12.00 (shtator 2026)**, të bashkëngjitur nga një ofertues tjetër në sqarimin e 13.10.2026 (respektivisht nga OE InterAdria), pra pas afatit të 25.08.2026. JOLIX dorëzoi versionin **v11.00**. Vetë Komisioni e ka cilësuar katalogun v12.00 të papranueshëm, sepse nuk ekzistonte para afatit (neni 29.1 i DT-së). Në gjetjet e Komisionit për JOLIX (05.10.2026), për pikën 4.3 nuk ka asnjë vërejtje. Konstatimi u fut më 22.10.2026, një ditë para vendimit, si

"çështje e përbashkët për të tri ofertat".

- JOLIX e ka pranuar pa kushte "Sqarimin Plotësues dhe të detyrueshëm për OE", që kërkon kompatibilitet të plotë, "në mënyrë që asnjë komponent i listuar të mos mbetet jo-funksional për shkak të mungesës së lidhjes ... ose aksesorit përkatës". Këtë e ka bërë me Aneksin 1 të vulosur dhe me Deklaratën e përputhshmërisë (Evidenca 12), me çmim fiks DDP. Çdo element lidhës është detyrim kontraktual i JOLIX pa kosto shtesë.
- **Ndaj arsyetimit të AK të 29.10.2026:** AK pretendon se letra e prodhuesit (Aneks A) i referohet kuotimit nr. 1172203.0, i cili nuk është pjesë e ofertës. Kuotimi nr. 1172203.0 është oferta financiare e Rohde & Schwarz drejtuar JOLIX SH.P.K. si furnizues, pra dokument komercial ndërmjet prodhuesit dhe ofertuesit. Për këtë arsye, natyrisht, nuk është pjesë e ofertës së dorëzuar në AK. Përmbajtja teknike e këtij kuotimi, pra konfigurimi ADD507, ADD5C-MMS dhe PR200 me të njëjtat numra artikujsh, është identike me kuotimin teknik nr. 1170419.0, i cili është dorëzuar me ofertë (Evidenca 11). Letra e prodhuesit Rohde & Schwarz nuk e ndryshon ofertën. Ajo vetëm konfirmon se konfigurimi i ofertuar me tender dorëzohet funksional, përfshirë adapterin SnapN nëse kërkohet. Konsiderojmë se AK ishte e obliguar ta sqaronte këtë fakt me OE ose me prodhuesin, sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së. Paqartësia nuk mund të shndërrohej në eliminim, dhe aq më pak një kërkesë e cila nuk ishte as në DT, as në Aneksin 1.

C. Pika 4.4: mangësi dokumentimi e plotësueshme; arsye e re e paraqitur vetëm në rishqyrtim

- AK pranon se "modeli dhe numri i artikullit janë identifikuar në ofertën e prodhuesit" (ADD17XZ8, 4096.1580.02), dhe Njësia kërkuese e cilëson rastin "mangësi në dokumentimin e artikullit". Mungesa e fotografisë është e plotësueshme sipas nenit 29.1 të DT-së dhe nenit 72.3 të LPP-së. Vizatimi zyrtar i prodhuesit me fotografi, nr. 4096.1580.01 D i datës 03.01.2012 (Aneks B), ekzistonte para afatit dhe verifikohet objektivisht.
- **Trajtim i pabarabartë i Kërkesës 11:** në Raportin e Vlerësimit (f.8), Katana vlerësohet "Në pajtim" për Kërkesën 11. Megjithatë, ajo nuk ka fotografi për të paktën nëntë artikuj, përfshirë po ato ADD17XZ8 dhe ADD5C-MMS. InterAdria vlerësohet "I papajtueshëm" për Kërkesën 11, por Raporti e quan "I përgjegjshëm".
- **Arsyeja e re e AK (29.10.2026):** AK pretendon se backpack-u në Aneksin 1 përshkruhet "për ADD107/ADD207 dhe DDF007, jo për ADD507". Kjo arsye nuk figuron as në Njoftimin e 23.10.2026, as në gjetjet e Komisionit. Ajo paraqitet për herë të parë në fazën e rishqyrtimit, pa i dhënë JOLIX SH.P.K. mundësinë të deklarohet. Përshkrimi në fjalë është teksti i katalogut të prodhuesit për artikullin ADD17XZ8, pra për të njëjtin artikull që e kanë ofruar edhe dy OE-të e tjerë. Prodhuesi Rohde & Schwarz konfirmon me shkresë zyrtare se ADD17XZ8 "is suitable for carrying the ADD507 antenna and the ADD5C-MMS cable set in the field" (Aneks A). Kjo shkresë i është dorëzuar AK-së bashkë me kërkesën për rishqyrtim të 28.10.2026. Megjithatë, AK nuk e ka marrë fare në konsideratë në vendimin e saj për pikën 4.4.

D. Raporti i Vlerësimit (B36) e konstaton ofertën e JOLIX të përgjegjshme

- Në Raport, për JOLIX shënohet "I përgjegjshëm, ka plotësuar minimumin e kërkesave ..." në të gjitha seksionet (f.2-7, 10 dhe 16), përfshirë "aftësinë teknike dhe/ose profesionale". Në listën e f.8, JOLIX është "Në pajtim" për Kërkesën 9, 10, **12 (përputhshmëria me specifikimet teknike)** dhe **13 (Aneksi 1)**, dhe "I papajtueshëm" vetëm për Kërkesën 11.
- Në vendimin e 29.10.2026, AK i cilëson këto shënime "gabim teknik shkrimi". Ky shpjegim nuk qëndron. Konstatimi përsëritet në disa faqe dhe në tabelën e f.8, të cilën AK nuk e adreson fare. Përfundimi i f.13, se "asnjëri nga OE nuk janë të përgjegjshëm", mbetet i paarsyetuar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 39.7 të Rregullores. Raporti mban datën 23.09.2026, por përmban ngjarje të 09.10-22.10.2026, dhe nënshkrimet e Komisionit janë pa datë.

E. Sqarim vetëm për njërin ofertues

AK i ka kërkuar sqarim vetëm InterAdria L.L.C. (letra e 09.10.2026, përgjigja e 13.10.2026; Raporti f.17).

Përmes këtij sqarimi InterAdria madje ndërroi produkte.

JOLIX-it nuk iu kërkua asnjë sqarim, as për pikën 4.3, as për pikën 4.4, ndonëse sipas vetë AK-së bëhet fjalë për paqartësi dhe mangësi dokumentimi. Kjo shkel nenet 7, 59.2 dhe 72 të LPP-së.

F. Ofertat e tjera janë të papërgjegjshme

AK i ka eliminuar edhe dy ofertuesit e tjerë dhe ka refuzuar kërkesën e InterAdria për rishqyrtim (29.10.2026). Mospërputhjet e tyre janë thelbësore dhe të pavarura nga ato të JOLIX:

- **InterAdria L.L.C.:** sqarimi i 13.10.2026 ndryshoi produktet te pikat 2.5 dhe 2.2 dhe u mbështet në katalogun e shtatorit 2026; pika 2.6 (GNSS) nuk dëshmohet; te pika 3.3 ofrohet HE400BC, që nuk është modul HF; te pika 4.3 kablloja është pa model; Kërkesa 9 ka referencë të rregullt vetëm për 79,230 EUR.
- **Poligoni i Shenjëtarisë Katana SH.P.K.:** Kërkesa 9 - kontrata e vetme është në realizim e sipër; Kërkesa 13 - Aneksi 1 nuk është dorëzuar në formularin e DT-së; Kërkesa 10 - autorizimi i prodhuesit për dilerin është i panënshkruar; Kërkesa 12 - deklaratë e kushtëzuar.

Për rrjedhojë, JOLIX është tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm, me çmim nën vlerën e parashikuar. Anulimi sipas nenit 62 të LPP-së nuk është i bazuar.

G. Kërkesa drejtuar OSHP-së

JOLIX SH.P.K. i propozon Panelit Shqyrtues që:

- ta aprovojë ankesën si të bazuar;
- ta anulojë vendimin e AK të 29.10.2026 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, si dhe Njoftimin mbi vendimin e AK të 23.10.2026 për anulimin e aktivitetit;
- ta kthejë çështjen në rivlerësim dhe ta obligojë AK-në që ta vlerësojë ofertën e

JOLIX vetëm sipas kërkesave të DT-së dhe dokumenteve të dorëzuara, duke kërkuar sqarim apo plotësim sipas neneve 59.2 dhe 72.3 të LPP-së për pikat 4.3 dhe 4.4, ose duke verifikuar drejtpërdrejt te prodhuesi;

- të urdhërojë kthimin e tarifës së ankesës sipas nenit 118 të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Anulimi i paligjshëm i aktivitetit e privon JOLIX SH.P.K. nga e drejta që t'i jepet kontrata si tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm, dhe për këtë arsye i shkakton fitim të humbur. Përveç kësaj, JOLIX SH.P.K. ka pasur shpenzime për përgatitjen e ofertës, për sigurimin e tenderit, për kërkesën për rishqyrtim dhe për këtë ankesë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*